

PERPJEKJA 26-27

mërgimi shqiptar
pas vitit 1990



Romë: 1:00' larg jush!

Paris: 2:00' larg jush!

Bratislavë: 1:40' larg jush!

Lubjanë: 1:00' larg jush!

Pragë: 1:40'

Zyrih:

isenBANK

LËNDA

- Editorial*
- 2 **Emigracioni - zhvillim apo varfërim**
nga Fatos Lubonja
- 4 **Hyrje në përmbajtjen e këtij numri**
të Përpjekjes mbi emigracionin
shqiptar pas vitit 1990
nga Eda Derhemi
- 11 **Shqipëria si një laborator për**
studimin e migrimit dhe zhvillimit
nga Russell King
- 29 **Fidanishtet e dhimbjes**
nga Ardian Vehbiu
- 38 **Kontakt nga afër**
nga A. Vehbiu, R. Devole
- 71 **“Letërnjoftimi biometrik” i**
emigracionit-shqiptarët në Itali
nga Rando Devole
- 101 **Poezi**
nga Filippo Davoli
- 105 **Gjuha e brezit të dytë imigrant**
në Greqi
nga Niko Gogonas
- 117 **“Ditar i shkurtër kufiri”**
nga Gazmend Kapllanit
- 130 **Poezi**
nga Romeo Çollaku
- 133 **Poezi**
nga Luan Xhuli
- 136 **Fenomenologji e brezit të parë të**
emigracionit: rasti i shqiptarëve
të pas-socializmit në ShBA
nga Eda Derhemi
- 156 **Migrimi i shqiptarëve të pas 90-ës**
në Londër
nga Zana Vathi
- 165 **Delja e zezë mes nesh ose meditime**
nëpër rrugicat e Zürich-ut dhe të
frikës njerëzore
nga Albana Rexhepaj
- 174 **Poezi**
nga Albana Shala
- 176 **Nga “gulag” komunist në geto**
ballkanike: Shqipëria dhe politikat
migratore në vite
nga Juli Vullnetari
- 188 **Solidariteti femëror dhe farefisi**
nga Erin Smith
- 211 **Poezi**
nga Giuseppina Demetra Schiro’
- 213 **Dukuri trafikimi dhe ritrafikimi**
nga Stephanie Schwandner-Sievers
- 233 **Trajektorët Psiko-Sociale të**
“Trafikantëve” Shqiptarë
nga Nick Mai
- 257 **Shqipe Mërgimi**

PERPJJEKJA

E përtremuajshme kulturore

Botim i Qendrës Përpjekja

PSE PO E HUMB GJUHËN AMTARE BREZI I RI I IMIGRANTËVE SHQIPTARË NË GREQI?

DISKRIMINIM DHE KRIZË IDENTITETI*

Nga **Dr. Nikos Gogonas***

Ky artikull kërkon të hedhë dritë mbi faktorët që ndikojnë në dobësimin progresiv të shprehive gjuhësore në shqip dhe, për rrjedhojë, të përdorimit të gjuhës shqipe në brezin e dytë të imigrantëve në Athinë, Greqi; një dukuri që zakonisht quhet *zëvendësim i gjuhës* (angl. *language shift*). Kemi analizuar këto ndryshore: statusin e imigrantëve shqiptarë (dhe të gjuhës së tyre) në Greqi; iniciativa të brezit të parë për mësimdhënie të gjuhës amtare (duke përfshirë krijimin e shoqatave shqiptare) dhe roli i arsimit grek në ruajtjen e gjuhës shqipe nga nxënësit shqiptarë. Analiza tregon se statusi i stigmatizuar i gjuhës shqipe në Greqi, 'fluiditeti' i identitetit shqiptar që karakterizon shumë prindër shqiptarë, mungesa e një politike arsimore në Greqi për të mbështetur gjuhët e 'pakicave', qëndrimet negative të mësuesve grekë ndaj shqipes si dhe shkalla e pamjaftueshme e organizimit mes atyre (pak) komuniteteve shqiptare që ekzistojnë në Greqi janë faktorët kryesorë që gjithnjë e më tepër po i bëjnë shumë të rinj shqiptarë ta zëvendësojnë shqipen me greqishten.

Hyrje

Që nga fillimi i vitit 1990, në Greqi erdhën një numër i madh imigrantësh shqiptarë, kryesisht për shkak të kolapsit të regjimit komunist në Shqipëri. Sot në Greqi ka rreth 600.000 imigrantë shqiptarë (Barjaba dhe King, 2005), prej të cilëve rreth gjysma me

* Nicos Gogonas ka përfunduar studimet pasuniversitare dhe doktoraturën në Universitetin e Sussex-it në Angli. Tani jep lëndët e bilingualizmit dhe edukimit ndërkulturor në lëndët e bilingualizmit dhe edukimit ndërkulturor në Universitetin e Athinës dhe të Thesalisë në Greqi.

dokumente të rregullta. Një numër i madh fëmijësh shqiptarë ndjekin shkollat filllore dhe të mesme. Nxënësit shqiptarë përfaqësojnë përqindjen më të lartë të nxënësve të huaj në sistemin arsimor grek. Kështu, në 1995, kishte 8.935 të tillë (kundrejt gjithsej 14.015 nxënësish të huaj) (Damanakis 1997), ndërsa në 2003 numri i nxënësve shqiptarë u rrit në 69.880 (kundrejt 96.526 nxënësish të huaj gjithsej) (IPODE, 2006). Sa për shpërndarjen e nxënësve shqiptarë në vend, sipas të njëjtave burime, shumica e tyre jetojnë në rajonet e Athinës (50.3%) dhe të Selanikut (10.7%).

Disa studime të kohëve të fundit, që janë kryer në Greqi, në lidhje me praktikën gjuhësore të nxënësve shqiptarë, tregojnë se këta karakterizohen nga shprehi të këqija në gjuhën shqipe dhe përdorim i kufizuar i saj (Gogonas 2009). Për shembull, rezultatet e një ankete me vetë-raportim që kam kryer me 70 nxënës shqiptarë në lidhje me shprehitë e tyre në gjuhën greke dhe shqiptare, tregojnë *mbizotërim* të përgjithshëm të greqishtes ndaj shqipes. Për më tepër, dallimi më i rëndësishëm në shprehitë gjuhësore të nxënësve shqiptarë në të dy gjuhët ka të bëjë me alfabetizimin (*literacy*). Kështu, edhe pse pothuajse të gjithë nxënësit (99%) raportojnë shprehi leximi të greqishtes të mjaftueshme ose shumë të mira, vetëm gjysma e tyre raportojnë shprehi të tilla për shqipen. Dallime edhe më të mëdha ekzistojnë në aftësitë për të shkruar: 98,5% raportojnë se e shkruajnë greqishten mjaftueshëm ose shumë mirë, ndërsa vetëm 32,8% mund ta shkruajnë shqipen mjaftueshëm ose shumë mirë.

Tërheq vëmendjen fakti që, në shumë raste, edhe kur nxënësit shqiptarë e njohin gjuhën e tyre amtare, përipiqen ta nënvlerësojnë këtë, duke pretenduar se dinë 'shumë pak' shqip, ose 'nuk dinë fare'. Pasazhi i mëposhtëm nga një intervistë me një nënë shqiptare e sqaron këtë prirje që ndeshet në disa fëmijë shqiptarë për t'u distancuar nga gjuha shqipe:

Kur vajza ime e vogla ishte në kopsht, më erdhi një ditë në shtëpi shumë e mërëzitur. Pastaj, motra e saj e madhe i foli në shqip. E vogla iu kthye me inat: 'Mos më fol shqip mua. Unë nuk di shqip! Nuk e merr vesh?' Fëmijës i vinte turp për gjuhën e vet, sepse kishte ndier atmosferën raciste në shkollë (Sonila, 40)¹

Ky artikull synon të hetojë disa nga faktorët që kanë ndikuar në këtë marrëdhënie të vështirë të brezit të dytë shqiptar me gjuhën e tyre amtare, në bazë të, kryesisht, një studimi njëvjeçar që kam kryer në Athinë, në 2005. Hetimin tim e nis duke diskutuar statusin e imigrantëve shqiptarë në Greqi.

Statusi i imigrantëve shqiptarë në Greqi

Shumë studiues të ruajtjes dhe të zëvendësimit të gjuhës kanë treguar si statusi

¹ Për arsye anonimiteti, të gjithë prindërit shqiptarë përmenden këtu me emra të ndërruar.

social-ekonomik i një grupi luan rol jetik në ruajtjen e gjuhës së grupit. Shqiptarët janë grupi më i madh i imigrantëve në Greqi, çka ka ndikuar në qëndrimet negative ndaj tyre. Reagimi grek ndaj imigrimit të më shumë se gjysmë milion shqiptarëve që prej vitit 1990 është shkaktuar dhe formësuar, në pjesën më të madhe, nga mediat, të cilat kanë luajtur rol të dorës së parë në krijimin e imazheve për Shqipërinë dhe shqiptarët. Këto imazhe kanë qenë përgjithësisht negative. Edhe pse në krye u mirëpritën, shqiptarët shpejt u denigruan me një varg stereotipash tepër negativë. Ky poshtërim tepër serioz ka pasqyruar praninë masive të imigrantëve shqiptarë, mungesën e imigrantëve të kombësive të tjera në numër të madh, dhe historinë e kundërvënieve greko-shqiptare gjatë periudhës otomane dhe më pas. Kapllani dhe Mai (2005) ia shtojnë një përmasë tjetër stigmatizimit. Ata parashtrajnë tri tema kryesore, të mbivendosura, që përvijohen në mënyrën si janë paraqitur imigrantët shqiptarë nga mediat greke: si kriminelë të lindur, si të varfër dhe të prapambetur nga natyra dhe të dënuar të mbeten ashtu, dhe si 'pushtues' ose 'armiq tradicionalë' për shkak të etnisë dhe fesë së tyre.

Ky 'tjetërsim' i shqiptarëve i ka rrënjët në kujtesën kolektive të grekëve për të kaluarën e tyre në varfëri, të kombinuar me autoritarizmin dhe që ka rezultuar në emigrim. Reaksioni grek është ndërlikuar edhe më, për shkak të pranisë, mes imigrantëve shqiptarë, të një numri të madh grekësh etnikë nga Shqipëria, të cilët trajtohen më mirë se shqiptarët 'e tjerë' ose 'të vërtetë', në lidhje me të drejtat e tyre në Greqi (meqë të parëve u jepen automatikisht viza dhe leje pune) si dhe me qëndrimet e popullsisë greke. Për një kohë të gjatë, imazhi standard i shqiptarëve në Greqi ka qenë si 'dinakë, primitivë, që nuk u zihet besë'... njerëz 'të rrezikshëm' dhe 'kriminelë' (Lazaridis dhe Wickens 1999, 648). Mediat greke janë marrë obsesivisht me temën e kriminalitetit shqiptar, çfarë ka sjellë ndryshime themelore në opinionin publik.

Identifikimet stereotipike që u diskutuan më lart, i kanë detyruar shumë imigrantë shqiptarë të adoptojnë strategji subversive, për të shmangur përjashtimin individual dhe për të ngjallur besim në komunitetin mikpritës (Mai dhe Schwandner-Sievers 2003). Pagëzimi dhe ndërrimi i emrave janë dy shembuj të strategjive të zgjedhura prej shqiptarëve për të përballuar situatën (Hart 1999; Hatziprokopiou 2003). Praktika e ndërrimit të emrave dhe e fshehjes së përkatësisë fetare, përveçse është përdorur si strategji 'mbijetese' nga shqiptarët në Greqi, sjell me vete edhe një farë mjegullimi të kufirit etnik midis identiteteve grek dhe shqiptar (Pratsinakis 2005). Shqiptarët që kanë emra grekë dhe që flasin greqisht mund të paraqiten si shqiptarë me prejardhje greke, për të marrë trajtimin preferencial që u bëhet, në Greqi, grekëve etnikë nga Shqipëria.

Deri në fillim të viteve 2000, nuk ishte marrë ndonjë masë e veçantë për integrimin e imigrantëve. Ligji 2910/2001 u njihte të huajve rezidentë të ligjshëm në Greqi të drejta të barabarta me ato të qytetarëve grekë, sa i përket sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale. Vetëm nërm: 2002 qeveria adoptoi, për herë të parë, një seri masash që kishin për qëllim integrimin. Plani i veprimeve për integrimin social të imigrantëve për periudhën 2002-2005 përfshin dispozita për trajnimin, integrimin në tregun e punës dhe kujdesin shëndetësor të imigrantëve; ngritjen e qendrave lokale të mbështetjes sociale dhe promovimin e shkëmbimeve kulturore midis komuniteteve të ndryshme. Deri më sot,

rezultatet e orvatjeve për ta zbatuar këtë plan mbeten të panjohura (Hatziprokopiou 2006). Megjithatë, në verë të vitit 2007 Ministria e Punëve të Brendshme miratoi një program politik të rëndësishëm, *Estia*, i cili synon të vlerësojë situatën e tanishme në lidhje me integrimin e imigrantëve, duke marrë parasysh praktika europiane dhe duke cilësuar përparësitë e një strategjie kombëtare për integrimin e imigrantëve (Triandafyllidou dhe Maroufouf, 2008). Një nga kanalet nëpërmjet të cilëve imigrantët shqiptarë në Greqi mund të marrin pjesë në jetën publike janë shoqatat e imigrantëve, shpesh në bashkëpunim me qytetarët dhe institucionet e vendit mikpritës². Këto, si dhe roli i tyre në mësimdhënien e shqipes, do të shqyrtohen në vijim.

Shoqatat shqiptare në Greqi: çfarë roli luajnë në mësimdhënien e gjuhës shqipe?

Shumica e shoqatave u krijuan pas programit të parë të rregullarizimit, në vitin 1998. Një shqetësim parësor i shoqatave ka qenë ruajtja e identitetit shqiptar, përballë paragjykimëve dhe racizmit. Me interes është këmbëngulja e shoqatave se ato nuk kanë ndonjë program të ngushtë politik, por vetëm qëllime kulturore dhe të identitetit. Kjo shpjegohet pjesërisht me të kaluarën komuniste, por edhe me marginalizimin e tyre brenda programeve socio-politike greke (Hatziprokopiou 2006). Siç kanë sugjeruar Barjaba dhe King (2005) për Greqinë dhe Italinë, organizimi në shoqata mes shqiptarëve është i dobët, para së gjithash për shkak të marginalitetit të statusit të tyre ekonomik dhe ligjor, por edhe për shkak të antipatisë së tyre ndaj organizatave komunitare, të cilat u kujtojnë të shkuarën komuniste.

Për më tepër, pjesëmarrja e imigrantëve shqiptarë në organizata imigrantësh mbetet shumë e ulët, në krahasim me grupe të tjera imigrantësh në Greqi dhe në vende të tjera. Hatziprokopiou (2006) ka gjetur një pjesëmarrje prej 18% në shqiptarët e Selanikut. Megjithatë, duhet bërë një dallim i rëndësishëm. Në studimin e tij për Selanikun, Hatziprokopiou (2006) vërejtë se, sidoqë shoqatat e imigrantëve nuk janë zhvilluar mjaftueshëm në gjirin e shqiptarëve, të tjera shoqata etnike ose kulturore janë formuar që në krye, me ndihmën e organizatave ekzistuese ose si pjesë e këtyre. Grekët etnikë dhe vllahët, në disa raste edhe njerëz me prejardhje nga e njëjta krahinë, duken shumë më të predispozuar për të krijuar organizata kolektive dhe për të milituar në to; pjesërisht për shkak se e kanë më të lehtë për t'u integruar, por edhe për shkak të perceptimit më të fortë që i bëjnë identitetit të tyre, që prej kohës kur jetonin në Shqipëri. Një shpjegim i mëtejshëm për këtë dallim ofrohet nga Piperno (2005), i cili sugjeron se shqiptarët priren ndaj asimilimit në vendin mikpritës dhe ngurrojnë të organizohen si kolektiv në

² Kohët e fundit, megjithatë, qeveria socialiste e zgjedhur rishitas (PASOK) ka përgatitur një projektligj me të cilin imigrantët do të fitojnë të drejtën e votës dhe të drejtën për të marrë shtetësinë greke në brezin e dytë.

bazë rregullash formale. Edhe Michail (2009), në një studim të kohëve të fundit për imigrantët shqiptarë në Greqinë veriperëndimore, ka treguar se shumë prej informantëve të saj u shprehën të frikësuar se anëtarësimi i tyre në shoqata të tilla do t'i distancojë nga komuniteti grek dhe do t'ua vonojë integrimin.

E njëjta frymë ngurrimi për të marrë pjesë nga veprimtari komunitare duket se është arsyeja për frekuentimin e ulët të kurseve të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga fëmijët me origjinë shqiptare. Kurse të gjuhës amtare shqipe janë organizuar nga dy shoqata shqiptarësh në Selanik (Shoqata e shqiptarëve të Selanikut dhe 'Nënë Tereza'). Megjithë fushatën paraprijëse për këto kurse dhe organizimin e një konference nga Universiteti i Selanikut, për të bërë të ditur publikisht ekzistencën e kësaj mundësie dhe për të theksuar rëndësinë e ruajtjes së gjuhës amtare, pjesëmarrja është shumë e ulët: vetëm 40 nxënës po i ndiqnin kurset e Shoqatës së shqiptarëve të Selanikut në 2006. Diçka e ngjashme ka ndodhur edhe me shoqatën 'Nënë Tereza'. Gjatë vitit të parë të mësimt, ishin regjistruar 62 nxënës, për të përfunduar 24 nxënës në 2006 (Maligkoudi 2009).

Megjithë faktin që Shoqata e shqiptarëve të Athinës nuk organizon kurse mësimore në gjuhën amtare për fëmijët, një shkollë private në qendër të Athinës, e drejtuar nga shqiptarë, organizon kurse kompjuteri dhe ofron orë mësimi në gjuhën shqipe falas për fëmijët. Intervista ime me drejtorin e shkollës nxjerr në pah jo vetëm një mungesë interesimi nga ana e prindërve shqiptarë për mësimin e gjuhës amtare, por edhe shprehitë e pamjaftueshme të fëmijëve shqiptarë në gjuhën amtare:

Për fat të keq, edhe pse ne po ofrojmë falas kurse të gjuhës shqipe për fëmijët, shumë pak prindër i kanë regjistruar fëmijët në shkollën tonë. Nga ana tjetër, ka pasur shumë interes për kurset e informatikës. Megjithatë, meqë kurset e informatikës zhvillohen në gjuhën shqipe, fëmijët nuk i ndjekin. Nuk e kuptojnë shqipen. Kam frikë se në të ardhmen do të detyrohemi t'i zhvillojmë kurset në greqishte, që të regjistrohen më shumë fëmijë.

Prindërit shqiptarë nuk duket t'u japin kurseve të gjuhës amtare përparësi në edukimin e fëmijëve të tyre, ose ngaqë nuk dinë se kurse të tilla ekzistojnë, ose ngaqë i mendojnë si të panevojshme, sa kohë që besojnë se gjuhën amtare mund t'ua përcjellin fëmijëve në shtëpi. Më poshtë do të shqyrtojmë shtrirjen e kësaj dukurie, si dhe praktikat gjuhësore që ndiqen në familjet shqiptare.

Qëndrimet e prindërve shqiptarë ndaj ruajtjes së gjuhës dhe iniciativat në këtë drejtim

Të gjithë prindërit shqiptarë të intervistuar janë shprehur në favor të ruajtjes së

gjuhës shqipe në fëmijët e tyre. Shumica e prindërve shqiptarë përmendin si arsye *vlerën edukative të gjuhës*; disa prindër i japin rëndësi ruajtjes së gjuhës për *arsye të riatdhesimit*; ndërsa një grup tjetër, më i vogël, përmend *identitetin etnik*. Ja një grup intervistash që ilustron arsyetime të tilla:

Fëmijët e mi duhet të mësojnë shqip, sepse sa më shumë gjuhë të dijë njeriu, aq më mirë është. Shqipja është një gjuhë më shumë (Jani, 47)

Arsyeja kryesore pse duam që fëmija të mësojë shqip është praktike. Një ditë mendojmë të kthehemi në vendin tonë (Gazmend, 43).

Arsyeja pse dua që fëmijët e mi të dinë shqip nuk ka të bëjë me kthimin e tyre në Shqipëri një ditë. Por fëmijët duhet ta dinë gjuhën e nënës. Nuk do të më vinte mirë sikur të harronin gjuhën e tyre amtare, prejardhjen tonë. I kam mësuar fëmijët të jenë krenarë për origjinën e tyre dhe të mos kenë turp që janë shqiptarë (Miranda, 38).

Megjithatë, siç do të shohim më poshtë, me gjithë qëndrimet e tyre në favor të ruajtjes së gjuhës, prindërit shqiptarë nuk marrin masa për këtë qëllim.

Të dhëna të grumbulluara nga 70 nxënës shqiptarë tregojnë se vetëm në 30% të familjeve prindërit komunikojnë me ta kryesisht ose vetëm në shqipe. Më poshtë do të analizojmë disa arsye se pse ndodh kjo. Pa dyshim, një nga arsyet ka të bëjë me shprehitë e mira në greqishte nga ana e shumë prindërve shqiptarë. Imigrantët shqiptarë në Greqi dallohen për shpejtësinë me të cilën mësojnë greqishte, kryesisht për t'u integruar sa më shpejt në shoqërinë greke. Përveç nevojës së tyre që të mësojnë greqisht, për t'u bërë 'të padukshëm' në shoqërinë greke dhe për të shmangur përjashtimin individual, një arsye e mëtejshme është dëshira e tyre për të vendosur lidhje sociale me popullatën greke. Disa shembuj marrëdhëniesh të tilla midis imigrantëve shqiptarë dhe punëdhënësve të tyre grekë dalin nga intervistat e mia me prindërit:

Ime shoqe punonte si pastruese në shtëpinë e kësaj gruas, që edhe na pagëzoi dhe u bë krushkë nderi në dasmën tonë (Ili, 45, Voula).

Unë punoja në shtëpinë e një çifti të moshuarish, dhe kujdesesha për ta. Më në fund, ata më bënë trashëgimtare e tyre. Trashëgova prej tyre shtëpinë ku jetoj tani me familjen time. Ata s'kishin fëmijë. Kishin të afërm e farefis, por unë bëra gjithçka që munda për t'i ndihmuar. Shkova në spital për ta; u kujdesa për varrimin, etj. (Eranda, 40, Kato Patissia).

Ndoshta nuk është për t'u habitur që të gjitha nënat shqiptare që intervistova në kuadrin e këtij studimi treguan shprehë pothuajse amtare në greqishte. Të dhënat nga intervistat me prindërit shqiptarë tregojnë se greqishtja, dora-dorës që e kanë

mësuar, ka ardhur duke zëvendësuar gjuhën e tyre amtare edhe në mjedisin shtëpiak:

Në krye flisnim vetëm shqip me njëri-tjetrin. Tani, megjithatë, flasim edhe shqip edhe greqisht. Na qëllon ta nisim një fjali në shqipe dhe ta mbarojmë në greqishte. Gjysmë për gjysmë, ndoshta më shumë greqishte (Irir, 45, Voula).

Në shtëpi, gjatë 7-8 vjetëve të parë, flisnim kryesisht shqip, sepse as gruaja ime as unë nuk dinim greqisht. Me kalimin e kohës, megjithatë, filluam ta zëvendësojmë shqipen me greqishte. Ndonjëherë e kam të vështirë ta gjej fjalën në shqipe (Saimir, 39, Palaio Faliro).

Është për t'u shënuar se këta veprojnë njëllor edhe kur kthehen në vendin e tyre:

Edhe kur jemi në Shqipëri, unë flas greqisht. Përdor fjalë greqishte, sepse nuk më kujtohen në shqipe (Irma, 40, Voula).

Disa prindër thonë se kanë përdorur greqishten me fëmijët kur i kishin të vegjël, meqë besonin se ashtu po ua lehtësonin futjen në sistemin arsimor grek, si dhe po i ndihmonin fëmijët të mësonin greqishten. Prindërit gjithashtu po u vinin vesh këshillave prej mësuesve, që t'u flisnin fëmijëve të tyre greqisht. Fragmentet e intervistës më poshtë i ilustronjë këto pika:

Kur vajza ime ishte foshnje, i flisja vetëm shqip, sepse në atë kohë nuk dija greqisht. Kur ajo u rrit aq sa të shkonte në kopsht, i flisja në të dy gjuhët, greqisht dhe shqip. E bëja këtë sepse ashtu do ta mësonte greqishten më lehtë. Unë edhe tani i ndihmoj me detyrat e shtëpisë, sepse ashtu edhe mua vetë më bën mirë, për greqishten (Miranda, 38).

Kur lindi im bir, i flisja vetëm shqip, derisa filloi të shkonte në kopsht. Që nga ajo kohë, nisa t'i flas greqisht, që të mos ndihej keq në shkollë. Pastaj u mësova edhe unë, dhe i kam folur greqisht që nga ajo kohë (Irma, 40).

Kur shkova një herë në shkollën e vajzës, mësuesja e saj e greqishtes më pyeti se ç'gjuhë përdorja në shtëpi me vajzën. I thashë: shqip. Atëherë mësuesja më tha: "Bën gabim të madh, sepse fëmija ngatërrohet dhe nuk ecën mirë në shkollë, ku flitet greqisht. Duhet të flasësh vetëm greqisht në shtëpi" (Jonida, 55).

Megjithatë, disa prindër sot janë penduar që u kanë folur greqisht fëmijëve të tyre. Ka interes të vërehet edhe se ata janë të vetëdijshëm se kjo praktikë është karakteristike për shumë prindër të komunitetit shqiptar:

Për fat të keq, kjo është diçka që ndodh pa u kuptuar. Ndonjëherë, unë e kap

veten duke i folur greqisht tim biri, pastaj ndihem keq, edhe pse nuk e bëj me vetëdije. Madje mua ata shqiptarë që u flasin greqisht fëmijëve të tyre më duken të marrë, mirëpo ja që edhe unë ashtu bëj (Ilir, 45).

Përveçse të përdorin gjuhën amtare në shtëpi, prindërit mund të bëjnë shumë më tepër për të përmirësuar transmetimin e gjuhës nga një brez në tjetrin, duke u siguruar fëmijëve materiale të shtypura në gjuhën amtare, duke u shfaqur video dhe këngë nga atdheu i tyre dhe duke organizuar udhëtime në vendin e origjinës.

Shumica e prindërve të intervistuar, përmendën mungesën e materialeve të shtypura shqip në shtëpitë e tyre, me përjashtim të gazetave shqiptare që mund t'i blejnë në Greqi. Çuditërisht, janë gjyshërit ata që u japin fëmijëve gjëra për të lexuar në shqip.

Sa për programet e televizionit shqiptar, shumica e prindërve marrin kanale satelitore shqiptare në shtëpi, por edhe shprehin pakënaqësinë e tyre që fëmijët janë krejtësisht indiferentë ndaj këtyre programeve:

Ndonjëherë, kur shohim një film shqiptar, u themi edhe vajzave të vinë ta shohin me ne, por ato nuk kanë interes (Jonida, 55).

Në shtëpi ato shumë rrallë shohin filma shqiptarë. U bleva një herë një film për fëmijë, por nuk u pëlqeu fare. Në përgjithësi, nuk kemi shumë gjëra nga Shqipëria. I pyeta vajzat se mos donin t'u jepja një poster të një këngëtari shqiptarë që do të marrë pjesë sivjet në Festivalin Europian. Nuk e deshën, prandaj ua dhashë nipave. U përpoqa t'u shpjegoj vajzave tekstin e këngës, por nuk treguan ndonjë interes. Në përgjithësi, ato nuk janë të interesuara (Ledina, 40).

Për të nxitur transmetimin e gjuhës, vizitat në atdhe, sidomos për periudha të gjata, duket se luajnë rol të dorës së parë. Nga kjo pikëpamje, afërsia gjeografike midis Greqisë dhe Shqipërisë ndihmon: shumica e familjeve shqiptare kthehen në atdhe me rrugë tokësore, me makinat e tyre. Në të vërtetë, disa nxënës shqiptarë thanë se, sa herë që janë në Shqipëri, e flasin shqipen më mirë dhe u kujtohen më shumë fjalë.

Megjithatë, imigrantët nuk mund ta vizitojnë vendin e tyre të origjinës sa herë që të duan, përveçse kur janë pajisur me një vizë udhëtimi të posaçme, e cila shpesh kërkon disa muaj që të sigurohet. Për këtë arsye, shteti grek u jep imigrantëve leje të veçantë, çdo vit, për Krishtlindje, Pashkë dhe gjatë verës, që ata të mund të kthehen në atdheun e tyre. Si rezultat, radhët në pikat e kalimit kufitar gjatë këtyre periudhave janë jashtëzakonisht të gjata. Për më tepër, burokracia e rënduar që çon në vonesa të mëdha gjatë kontrollit të pasaportave dhe trajtimi i keq që ata thonë se u bëhet nga zyrtarët grekë në kufirin shqiptaro-grek e ndërlikon edhe më perspektivën e një vizite në atdhe. Këtë e ilustron fragmenti i mëposhtëm:

Sa herë që shkojmë me pushime në Shqipëri, duhet të rrimë në radhë në kufi për deri tri ditë rresht. Një herë mua m'u desh të prisja tri ditë dhe, shyqyr Zotit, nuk e kisha fëmijën me vete. Një herë tjetër, kur isha me tim shoq dhe fëmijën, pritëm 14 orë në kufi! As shërbime sanitare, as gjë tjetër. Dhe e keqja është se situata mbetet e pandryshuar. Unë preferoj të bëj dyfishin e rrugës dhe të kaloj nga Kakavija, sepse atje kontrolli është OK. Por këtëj (nga Kapshtica) është i tmerrshëm, unë gjithnjë dridhem nga frika, nuk e di se ç'do të më bëjnë. Do të ma grisin kartën e identitetit? E ndiej veten sikur kam vrarë gjithë dynjanë! Ata bëjnë punën e tyre kur kontrollojnë, por unë kam frikë (Donika, 38).

Shumica e prindërve shqiptarë do të ishin dakord që gjuha amtare të ofrohej në shkollat greke. Megjithatë, disa prindër shqiptarë, të vetëdijshëm për statusin e diskriminuar të shqiptarëve në Greqi, shprehin shqetësim për mënyrën si do të reagojnë prindërit dhe nxënësit grekë, ndaj mësimdhënies së shqipes në shkollë. Në fragmentin e mëposhtëm, një prind shqiptar shpreh dëshirën që shqipja të ofrohet si lëndë në shkollën e fëmijës së vet, por njëkohësisht preferon që kjo të mos bëhet gjerësisht e ditur:

Do të doja që shqipja të ofrohej në shkollën e fëmijëve, por vetëm në qoftë se kjo nuk merret vesh nga të gjithë, që të mos ketë reagime prej grekëve. Sepse po të ketë reagime të tilla, atëherë fëmijët do të ngurrojnë para se të vendosin të ndjekin mësimet, pavarësisht nga sa do t'i shtyjme ne prindërit (Saimir, 39).

Pasazhi i mësipërm tregon një 'prirje asimilimi', meqë për këtë prind shqiptar konformimi me dëshirat e prindërve grekë sjell me vete 'integrimin' në shoqërinë greke, përkundrajt humbjes së gjuhës shqipe dhe identitetit përkatës. Nga ana tjetër, i intervistuari ka një farë të drejte në çfarë thotë, po të mbahen parasysh reagimet e forta nga ana e zyrtarëve të Ministrisë së Arsimit në Athinë, kur u bë e ditur se një shkollë fillore shtetërore në kryeqytetin grek po ofronte kurse të gjuhës shqipe. Hollësi të mëtejshme për këtë çështje do të jepen në seksionin vijues.

Roli i arsimit grek

Greqia është një shtet ku arsimit është i orientuar ndaj idealit të 'një kombi, një feje, një gjuhe'. Vetëm një fe (Krishterimi grek ortodoks) njihet si fe zyrtare, dhe vetëm një gjuhë (greqishtja moderne) si gjuhë zyrtare e shtetit. Sistemi arsimor dhe programet përkatëse janë ndërtuar në mënyrë të tillë, që t'i përshtaten një mase nxënësish të krishterë, mono-etnikë dhe të një gjuhe të vetme. Shndërrimi i Greqisë në një vend imigrantësh në fillim të viteve 1990 u shoqërua me disa përpjekje për të hartuar strategji dhe adoptuar mjete për ruajtjen e gjuhëve të pakicave. Megjithatë, këto janë ende në foshnjërinë e tyre, sidomos sa kohë që këto gjuhë lidhen me 'armiqtë tradicionalë' të

vendit (si shqiptarët). Deri më sot, i vetmi shqetësim që kanë shprehur institucionet arsimore dhe politike në Greqi ka të bëjë me mësimdhënien e suksesshme të greqishtes si gjuhë të dytë, ndërsa çështjet e ngritura nga përkrahësit e arsimit anti-racist dhe ndër-kulturor, si nga akademia ashtu edhe nga mjediset arsimore, kanë pasur vetëm efekt minimal dhe sporadik në sistemin arsimor konvencional, duke mbetur të varura nga interesimi dhe entuziazmi i arsimtarëve të veçantë. Disa praktika të mira në këtë drejtim u vunë në jetë nëpërmjet programeve të arsimimit ndër-kulturor të financuara nga BE, gjatë viteve 1997-2004. Këto parashikonin edhe futjen e gjuhës shqipe në një numër shkollash të ashtuquajtura 'ndër-kulturore', nëpërmjet tekstesh mësimore dygjuhëshe greqisht-shqip dhe me përfshirjen e ndihmës-mësuesve dy-gjuhësh shqiptarë. Megjithatë, këto programe u zbatuan në mënyrë eksperimentale dhe u ndërpre në bashku me financimet nga BE.

Studime të tjera kanë treguar se arsimtarët në poste drejtuese, ose që shihen si 'autoritete' nga prindërit shqiptarë, kanë dekurajuar përdorimin e gjuhës etnike në shkolla dhe nënvlërësuar rëndësinë e saj për procesin arsimor, duke shprehur pikëpamje negative dhe ndonjëherë raciste për mësimdhënien e shqipes në shkollë. Vetëkuptohet se qëndrimet e përfaqësuesve institucionalë të arsimit ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi mbi prindërit shqiptarë, për sa u përket zgjedhjeve gjuhësore dhe strategjive të tyre në lidhje me transmetimin e gjuhës amtare drejt brezit të dytë.

Tipik, në këtë kontekst, paraqitet rasti i shkollës fillore 132 Grava, në Athinë. Mësuesit e asaj shkolle, të mbështetur nga Universiteti i Athinës dhe Universiteti "Aristotel" i Selanikut, u ofruan vullnetarisht kurse ndër-kulturore të gjuhës shqipe nxënësve shqiptarë dhe kurse të greqishtes prindërve shqiptarë, për një periudhë pesëvjeçare. Në 2008, nën presionin e Ministrisë greke të Arsimit, Byroja e Arsimit zëvendësoi drejtorin e shkollës dhe i pezulloi programet ndër-kulturore, sa inovative aq edhe të mirënjohura. Administratorët e rinj të shkollës ngritën padi gjyqësore kundër drejtorit të mëparshëm dhe mësuesit të gjuhës shqipe, me akuzën se "kishin përdorur mjediset e shkollës për mësimdhënie të gjuhës shqipe pa leje me shkrim nga byroja e arsimit." Të dy gratë dolën në gjyq, por u liruan nga akuza.

Përfundim

Të dhënat studimore për shprehitë gjuhësore të fëmijëve me origjinë shqiptare dhe zakonet e përdorimit të gjuhës në familjet shqiptare, tregojnë se brezi i dytë i shqiptarëve në Greqi po e humbin gjuhën e tyre me shpejtësi. Folësit në moshë të re tregojnë parapëlqim të padiskutueshëm për përdorimin e greqishtes në komunikim, veçanërisht mes tyre. Gjithashtu, se çfarë gjuhe përdorin në komunikim me bashkatdhetarë të tjerë varet nga kompetenca e tyre në gjuhën amtare: me rrëgjimin e kësaj kompetence, rrëgjohet edhe përdorimi i gjuhës amtare. Studimet tregojnë se nxënësit shqiptarë janë të vetëdijshëm për statusin e stigmatizuar të grupit të tyre në Greqi dhe dëshirojnë të distancohen nga identiteti dhe gjuha e stigmatizuar. Nga ana tjetër, edhe pse e konsiderojnë ruajtjen e gjuhës si detyrë ideale, prindërit shqiptarë

nuk bëjnë ndonjë përppjekje të madhe për t'ua transmetuar gjuhën amtare fëmijëve të tyre. Prestigji i perceptuar i greqishtes si gjuhë e mobilitetit social nga poshtë lart dhe fluiditeti i përgjithshëm i identitetit etnik së bashku me një prirje për asimilim që i karakterizon shumë prindër shqiptarë bën që këta të përqafojnë greqishten duke hequr dorë nga ruajtja e gjuhës amtare dhe transmetimi i saj brezit tjetër.

Përdorimi i gjuhës amtare dhe perspektivat e ruajtjes së saj në brezin e dytë lidhen jo vetëm me qëndrimet dhe përppjekjet e prindërve, por edhe me ato të shoqërisë mikpritëse. Veçanërisht sistemi shkollor mund të luajë rol të dorës së parë për të inkurajuar ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor, duke i favorizuar këto identitete nëpërmjet programeve institucionale por edhe nëpërmjet orientimeve dhe qëndrimeve që vetë mësuesit u përcjellin nxënësve dhe familjeve të tyre. Megjithatë, mbështetja institucionale për shqipen në Greqi është minimale dhe sistemi arsimor grek ende ka shumë për të bërë, që të hapet plotësisht ndaj diversitetit të sjellë prej nxënësve të huaj, që janë para së gjithash shqiptarë. Edhe pse roli i sistemit shkollor mbetet kritik, ruajtja e gjuhës dhe e kulturës shqipe si dhe lidhjet me vendin e origjinës mund të promovohen, deri diku, nga vetë komunitetet shqiptare në Greqi. Tani për tani, megjithatë, këto komunitete kanë treguar aftësi të pakta për t'u organizuar. Duket e pagjasë që brezi i dytë do të mbajë marrëdhënie të mjaftueshme me Shqipërinë. Teksa të rinjtë shqiptarë po vijnë duke u asimiluar në shoqërinë greke, lidhjet e dobëta me gjuhën dhe kulturën e tyre amtare mund t'i shterojnë të gjitha marrëdhëniet me vendin e origjinës. Shqipëria mund të shoqërohet, në mendje, me kujtime fëminie për pushimet e verës ose një vend që i përket brezit të prindërve, por pa rëndësi për jetën e tyre të tanishme dhe në të ardhmen. Në të njëjtën mënyrë, gjuha shqipe mund të marrë, për brezin e ri, një funksion vetëm simbolik, në rastin më të mirë.

BIBLIOGRAFI

Barjaba, K. dhe King, R. (2005) Introducing dhe theorising Albanian migration. Në R. King, N. Mai, dhe S. Schwandner-Sievers (eds) *The New Albanian Migration*. Brighton: Sussex Academic Press, 1–28.

Damanakis, M. (ed) (1997) *The education of repatriated dhe foreign pupils in Greece. An intercultural approach [greqisht]* Gutenberg, Athens, Greece

Gogonas, N (2009) Language Shift in Second Generation Albanian Immigrants in Greece, *Journal of Multilingual dhe Multicultural Development*, 30 (2), 95-110

Hart, L. (1999) Culture, civilization dhe demarcation at the northwest borders of Greece. *American Ethnologist* 26 (1), 196-220

Hatziprokopiou, P. (2003) Albanian immigrants in Thessaloniki, Greece: Processes of economic and social incorporation. *Journal of Ethnic and Migration*

Studies 29 (6), 1033-1057.

Hatziprokopiou, P (2006) *Globalisation, migration dhe socio-economic change in contemporary Greece. Processes of social incorporation of Albanian dhe Bulgarian immigrants in Thessaloniki*. IMISCOE Dissertations. Amsterdam: AUP

IPODE (2006) Statistical data on the distribution of repatriated Greek dhe foreign pupils in Greece (komunikim personal)

Kapllani, G. dhe Mai, N. (2005) “Greece belongs to Greeks”! The case of the Greek flag in the hands of an Albanian student. Në R.King, N. Mai, dhe S. Schwandner-Sievers (eds) *The New Albanian Migration*. Brighton: Sussex Academic Press, 153-72.

Lazaridis, G. dhe Wickens, E. (1999) ‘Us’ dhe the ‘Others’: ethnic minorities in Greece. *Annals of Tourism Research*, 26(3), 632-55.

Mai, N. dhe Schwandner-Sievers, S. (2003) Albanian migration dhe new transnationalisms. *Journal of Ethnic dhe Migration Studies*, 29(6), 939-48.

Maligkoudi, C (2009) The Language Education of Albanian Pupils in Greece. Government Policies dhe Family Strategies [greqisht]. Tezë PhD e pabotuar, Universiteti i Kretës.

Michail, D (2009) Working here, investing here dhe there: present economic practices, strategies of social inclusion dhe future plans for return among the Albanian immigrants in a Greek-Albanian border town, *Southeast European dhe Black Sea Studies*, 9 (4), 539-554

Pratsinakis, E. (2005) Aspirations dhe strategies of Albanian immigrants in Thessaloniki. *Journal of Southern Europe dhe the Balkans*, 7(2), 195-212.

Piperno, F. (2005). Albanian migrants’ remittances: A development opportunity? Në *The new Albanian migration*, ed. R. King, N. Mai, dhe S. Schwandner-Sievers, 118–38. Brighton: Sussex Academic Press.

Triandafyllidou, A. dhe Maroufof, M. (2008) Immigration towards Greece at the Eve of the 21st Century. A Critical Assessment. Report prepared for the IDEA project. I pabotuar, Athinë, ELIAMEP, Maj 2008.